

PJESA HYRËSE - ABSTRAKTI

1. Objekti, qëllimi dhe arsyet e trajtimit të tematikës së hedhjes së aktakuzës

Sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës në periudhën kohore nga viti 2018 e deri në vitin 2022 është përcjellë nga shumë zhvillime të rëndësishme të shoqëruara nga kompleksiteti i procedurave gjyqësore me përpjekje për arritjen e rezultateve të drejta dhe të kënaqshme. Sfiduese për këtë periudhë kohore ka qenë edhe hedhja e aktakuzave në Gjykatën Themelore në Prishtinë, proces ky që është përcjellë me debate dhe argumentime të ndryshme. Procesi i hedhjes së aktakuzës në këtë punim i është nënshtruar hulumtimit dhe analizimit të thellë, duke u përqendur në inicimin dhe zhvillimin e tërë procedurës ligjore që duhet ndjekur nga subjektet. Objekt i këtij punimi është hedhja e aktakuzës. Qëllimi i këtij punimi është zhvillimi i një analize gjithëpërfshirëse çështjes së hedhjes së aktakuzës e mbi këtë bazë edhe nxjerrja në dritë e përparësive dhe mangësive që e karakterizojnë këtë proces.

Arsyet kryesore që më kanë shtyrë për trajtimin e tematikës së hedhjes së aktakuzës janë:

1. Mungesa e punimeve gjithëpërfshirëse lidhur me hedhjen e aktakuzës;
2. Dhënia e sygjërimeve se si një proces i tillë do duhej zbatuar mbi bazën e argumenteve bindëse dhe në respektim të plotë të zgjidhjeve ligjore në fuqi;
3. Analiza e funksionalitetit të zgjidhjeve ligjore, përparësitë dhe mangësitë që ato kanë.

Për të kuptuar në tërësi esencën dhe realizimin e fenomenit të hedhjes së aktakuzës punimi do ngërthej në vete nocionet, shpjegimet dhe kuptimin e aktit akuzues (aktakuzës) në përgjithësi duke filluar nga përmbajtja e aktakuzës e deri tek konfirmimi i saj dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor. E gjithë kjo ngase aktakuza paraqet një rëndësi të rëndësishme të procedurës penale përmes të cilës synohen që të trajtohen veprat e kundërligjshme me të cilat cenohen të drejtat dhe liritë e njeriut.

Punimi nuk do të përfshijë procesin e hedhjes së aktakuzës në Gjykatat e tjera të Republikës së Kosovës por vetëm Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë periudhës 2018-2022.

2. Metodatat e punës

Gjatë përgatitjes së këtij punimi të masterit kam përdorur këto metoda:

Metoda juridike: Përmes kësaj metode kam arritur të bëjë analizën e zgjidhjeve ligjore që e rregullojnë hedhjen e aktakuzës në Gjykatën Themelore në Prishtinë si dhe në disa prej shteteve që i kam marrë në krahasim.

Metoda analitike: Përmes kësaj metode kam arritur të bëjë analizimin dhe shpjegimin e informacioneve dhe të dhënave lidhur me hedhjen e aktakuzës në mënyrë sistematike dhe të strukturuar.

Metoda statistikore: Përmes kësaj metode kam arritur të nxjerrë përfundime nga të dhënat që janë mbledhur në një mënyrë sistematike. Kjo përfshin përdorimin e koncepteve, teknikave dhe modeleve statistikore për të interpretuar dhe për të bërë përfundime bazuar në të dhëna të sakta për procesin e hedhjes së aktakuzës.

Metoda krahasuese: Përmes kësaj metode kam arritur të realizoj krahasimin e hedhjes së aktakuzës si proces në Kosovë me disa shtete të tjera, duke përfshirë Shqipërinë, Kroacinë dhe Italinë. Ndër të tjera, kjo metodë më ka mundësuar që të vlerësoj ndikimin e variablave dhe ndryshimeve të hedhjes së aktakuzës në kushte të ndryshme ligjore.

3. Struktura e punimit

Ky punim masteri me titull *“Hedhja e aktakuzës në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës 2018-2022”* është i ndarë në tre kapituj, pjesën hyrëse, përfundimet, rekomandimet dhe literaturën e përdorur.

Në pjesën hyrëse trajtohen objekti, qëllimi dhe arsyet e hedhjes së aktakuzës, metodat e punës dhe struktura e punimit.

Në kapitullin e parë të titulluar *“Aspekte të përgjithshme të aktakuzës dhe hedhjes së saj”* trajtohen dokumentet që i bashkangjiten aktakuzës, verifikimi, publiciteti si dhe përmbushja e detyrimit të Prokurorit të Shtetit ndaj palës mbrojtëse, për të vazhduar me caktimin e shqyrtimit fillestar të aktakuzës, konfirmimin e saj dhe caktimin e shqyrtimit gjyqësor.

Në kapitullin e dytë të titulluar “Vështrim krahasues i hedhjes së aktakuzës” trajtohet hedhja e aktakuzës sipas Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë, hedhja e aktakuzës sipas Kodit të Procedurës Penale të Kroacisë dhe Kodit të Procedurës Penale të Italisë si dhe pikat e përbashkëta dhe dalluese në kodet e lartpërmendura në krahasim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Në kapitullin e tretë të titulluar “Hedhja e aktakuzës në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë periudhës 2018-2022” trajtohet numri i aktakuzave të hedhura, shkaqet mbi bazën e të cilave janë hedhur aktakuzat, veprat penale për të cilat janë hedhur aktakuzat, të dhënat personale të personave për të cilët janë hedhur aktakuzat si: mosha, gjinia, niveli arsimor dhe statusin social të tyre. Gjithashtu, në fund është analizuar një rast nga praktika gjyqësore të hedhjes së aktakuzës në procedurën penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë.